



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe neneve 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 4 nga udhëzimet për renditjen e lëndëve për veprimin e Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit në bazë të denoncimeve të dorëzuara, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në vazhdimin e seancës së 51-të, të mbajtur më datë 01.09.2021 morri

Vendim

Denoncimi me numër 12 – 606/1 të datës 27.01.2020, e dorëzuar nga parashtrues i panjohur, REFUZOHET.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, KSHPK nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtutjeshëm në lëndën me numër 12 – 6060 të vitit 2020, e formuar sipas denoncimit 12 -606/1 të datës 27.01.2020.

Lënda me numër 12 -606 të vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12 -606 të vitit 2020 e formuar sipas denoncimit 12 -606/1 të datës 27.01.2020. dorëzuar nëpërmjet adresës elektronike në Komisionin shtetërorë për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) nga parashtrues i panjohur – denoncim anonim.

Në denoncim janë nxjerrë dyshime në procedurën për zgjedhjen e drejtorit në ----- dhe theksohet se është zgjedhur pa pasur përvojë pune të mjaftueshme dhe arsim adekuat, por nuk theksohet se në cilën institucion është kryer përzgjedhja dhe cili person ishte dhe për cilën periudhë bëhet fjalë.

Gjatë shqyrtimit të lëndës, KSHPK konstaton se në denoncimin e dorëzuar nuk ka pohime të qarta ose sugjerime për veprime joligjore ose të palejuara të personave zyrtar gjatë kryerjes së shërbimeve zyrtare, me çka vlerësoi se nga denoncimi nuk mund të përcaktohen elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për rastin e lëndës dhe KSHPK nuk do të marr veprime për veprim të mëtutjeshëm, denoncimi të refuzohet, ndërsa lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTEТЁRORE
PЁR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorёzuar nё: - Arkiv
Punoi: J.C.
Miratoi: N.B, Anёtar i KSHPK-sё

